UDHËZIM
Nr. 366, datë 21.9.2017

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618, DATË 7.9.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA", TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të pikës 27 të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.330 (dhjetë mijë e treqind e tridhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuara.
2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, bëhet 10.330 (dhjetë mijë e treqind e tridhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, të vendimit dhe 10.850 (dhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj për kujdestarin.
3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2017 dhe përballohen me fondet akorduara për vitin 2017, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
4. Udhëzimi nr. 17, datë 30.8.2016, i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2017.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu